




Shënime mbi monografinë
STUDIMI GJUHËSOR PËRQASËS
(Në pamje metodologjike, teorike e praktike) të autorit Artan Fida

LIBRI *Studimi gjuhësor përqasës (Në pamje metodologjike, teorike e praktike)*, përbën një kontribut të vyer në fushën e studimeve teoriko-metodologjike të krahasimit përqasës midis gjuhëve, në vendin tonë. Ai është i pari studim në shqip i botuar tek ne në formën e një libri, krahasuar me kontributet teoriko-historike më të hershme të trashëguara në literaturën e shqipes në këtë fushë, të cilat janë që të gjitha vetëm në nivelin e artikujve të shkurtër, të përshtatjeve e, në ndonjë rast, në formën e hyrjes e të parathënies në tema masterash e doktoratash të pabotuara. Si i tillë, libri bart vlera shumëplanëshe. Së pari, ai ka vlerë informuese: në të sillet informacion mbi zhvillimin, arritjet dhe prirjet aktuale të studimeve përqasëse, si në rrafsh gjuhësor, ashtu edhe në ato ligjërimor, leksikor, semantik, pragmatik e kulturor. Së dyti, ka vlerë përshkruuese: në të parashtrihen kriteret shkencore dhe procedurat e kryerjes së krahasimit ndërgjuhësor. Së treti, ka vlerë ilustruese-praktike: sjell shembuj konkretë krahasimi midis gjuhëve të ndryshme, përfshirë dhe shqipen. Së fundmi, ka edhe vlerë udhëzuese-metodologjike: në të jepen nocionet, kriteret, fazat dhe mjetet me të cilat kryhet një krahasim ndërgjuhësor.

Veç *Parathënies e Bibliografisë*, libri përmbledh edhe 6 krerë të mirëfilltë. Në kreun I, përmbledhtazi, jepet një panoramë e lindjes dhe e zhvillimit të studimeve përqasëse, shpjegime mbi terminologjinë e tyre, përkufizimet e tiparet e tyre, lidhjet e gjuhësisë përqasëse me disiplina si glotodidaktika, përkthimologjia, gjuhësia deskriptive, leksikografia dygjuhëshe, bilinguizmi etj. Kreu II sqaron dukuritë e transferit e të interferencës gjuhësore në rrafsh psikologjik, psiko-sociolinguistik e gjuhësor dhe, në vijim, dukurinë e gabimit, shkaqet e lindjes

së tij dhe rolin që ushtron gjuha amtare mbi të nxënit e gjuhës së huaj. Kreu III qartëson nocionet bazë të studimit përqasës, si krahasueshmëria, barasvlera, pika e referimit (*tertium comparationis*), vështirësia në të nxënin gjuhësor dhe shkalla e matjes së saj, marrëdhëniet që vendosen mes dy gjuhëve kur ato hyjnë

në kontakt etj. Kreu IV paraqet modelet ose qasjet teorike të përshkrimit të gjuhëve, që shërbejnë si kornizë e domosdoshme teoriko-referuese për kryerjen e çdo krahasimi (modelet tradicional, strukturalist, gjenerativist dhe ndonjë tjetër), duke dhënë shkurtazi, për secilin prej tyre, tiparet themelore dhe shembuj krahasimi ndërgjuhësor të përzgjedhur nga studiues shqiptarë e të huaj. Kreu

V analizon procedurën që studiues të ndryshëm kanë ndjekur për kryerjen e kërkimit përqasës, fazat nëpër të cilat duhet të kalojë detyrimisht një krahasim

ndërgjuhësor, si dhe kriteret përkatëse të kryerjes me sukses të tij. Kreu i fundit ilustron praktikisht mënyrën konkrete të kryerjes së krahasimit në rrafshin fonetikor, gramatikor, leksikor, ligjërimor, tekstori e kulturor. Në mbyllje të punimit të vet, autori ka paraqitur një tematikë të përgjithshme e me interes për orientimin e studimeve përfaqësuese në fushat e mësipërme.

Studimi është mbështetur mbi një bibliografi shumë të pasur me tituj autorësh vendas e të huaj, me një shtrirje kohore që përfshin periudhën që nga lindja e studimeve përfaqësuese e deri në ditët e sotme. Dhënia e referencave bibliografike në tërësi, paraqitet e kryer me rigorozitet shkencor, por ato u takojnë më shumë botimeve të hershme e më pak atyre të kohëve të fundit.

Mendojmë se libri ia ka arritur qëllimit të vet: atë të pajisjes së studiuesve të rinj me udhëzime teorike e metodologjike, si dhe me shembuj praktikë të mënyrës së kryerjes të kërkimit gjuhësor përfaqësues. Edhe pse trajtesa është kryesisht në rrafshin teorik e metodologjik, autori është përpjekur të shmangë teorizimet e tepruara dhe të sjellë sa më shumë shembuj ilustrues. Ndër këta të fundit, sipas rrafshit të krahasimit, do të kishte qenë mbase më me interes që të ishin përfshirë më shumë shembuj nga studime ku shqipja përbën njërin prej gjuhëve të krahasuara.

Nga pikëpamja e strukturës së librit, midis krerëve ka një lidhje të natyrshme e racionale: pasi parashtrihen koordinatat e fushës së studimit, lindja dhe zhvillimi i saj, si dhe kontributet e autorëve të ndryshëm, kalohet shkallë-shkallë në shpjegimin e nocioneve themelore të fushës së kërkimit përfaqësues, në modelet e përshkrimit gjuhësor, që shërbejnë si kornizë brenda së cilës të kryhet krahasimi, në fazat e procedurës së krahasimit, për të arritur në pjesën praktike, atë të ilustrimit me shembuj krahasimi për secilin rrafsh të zgjedhur për krahasim. Tek-tuk kjo rrjedhje e natyrshme e mendimit ndërpritet me ndërfitjen e ndonjë sythi, që ka lidhje jo të drejtpërdrejtë me kryerjen e kërkimit përfaqësues, por që autori ka zgjedhur ta trajtojë aty në marrëdhënien të ngushtë me nocionin përfaqësues përkatës. P.sh., kur sqaron nocionet e transferit e të interferencës, në bashkëlidhje me ta ka sqaruar edhe nocionin e gabimit, llojet e tij, shkallët e vështirësisë së tij, njohuri këto që nuk përfshihen domosdoshmërisht në fushën e krahasimit ndërgjuhësor, por janë më shumë çështje që e pasojnë përfaqësimin ndërgjuhësor duke u trajtuar me të drejtë në fusha si glotodidaktika e psikolinguistika.

Edhe pse autori sjell shumë ilustrime përkufizimesh të termave e nocioneve të ndryshme të bëra nga studiues të huaj e shqiptarë, ai nuk mban qëndrim kritik ndaj tyre; me sa duket, ka preferuar t'ia lërë në dorë lexuesit të zgjedhë vetë se cilin prej tyre pëlqen e zgjedh për t'iu referuar, në varësi, natyrisht, të kornizës gjuhësore referuese dhe të objektit të zgjedhur për krahasim. Autori është përpjekur të jetë racional në përzgjedhjen e shembujve ilustrues, duke respektuar kriterin e baraspeshës midis fushave në të cilat kryhet krahasimi.

Duke u përpjekur të jetë shterues në trajtimin e çështjeve të ndryshme, autori na ka sjellë një libër tejet voluminoz; aq më shumë po të marrësh parasysh edhe madhësinë e vogël të shkronjave, imtësinë e të cilave është përpjekur ta kompensojë me një lloj shkrimi më të hapur. Megjithatë, jemi të bindur se kritikën më të mirë librit do t'ia bëjnë vetë studiuesit e fushës së kërkimit përqasës, si njerëzit me interesa të drejtpërdrejta, me njohuri në këtë fushë dhe, më në gjendje, për ta parë atë me sy objektiv.

Adrian Beshaj